


REPUBLIC OF KOSOVA		REPUBLIKA KOSOVA	
GOVERNMENT OF KOSOVA		VLADA KOSOVA	
OFFICE OF THE PRIME MINISTER		ZEMBJE E PËRHEMBËRËS	
SEKTORI I ARRIVËS		SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
No. Prof. Reg. No.	1059-38	Data: Datum:	25/04/2018
No. Çësje B. Shënime No. 1398	4-	Pristinë/a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture - Ministry of Infrastructure

Kabineti i Ministrit

DATE/A:	25.04.2018
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Z.Ramush Haradinaj, Kryeminister
CC:	Z.Pal Lekaj, Minister -MI
PERMES/	
NGA/OD/FROM	Fehmi Mujota, Zv.Minister-MI 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punes

I nderuari Kryeminister,

Ne poziten e Zv.Ministrit ne Ministrine e Infarastruktures jam emeruar me: 05.12.2018. Meqenese edhe me pare isha pjese e kesaj Ministrie te Qeverise se Republikes se Kosoves e kisha te lehte përfshirjen ne agjendat politike dhe projektet e ministrise, perfshire planin vjetor te punes te secilit departament veq e veq.

Pas njohjes me Kabinetin e Ministrit, ndarjes dhe caktimit te agjendave menaxhuese jam angazhuar nga fillimi ne implementimin e projekteve prioritare, planifikimin buxhetor dhe afatin e realizimit te projekteve.

Kam percjelle nga afer projektet e shumeta te realizuara, projektet ne realizim e siper si dhe fillimin e projekteve te reja qe do te vazhdojne edhe ne vitet e ardhshme.

Qe nga fillimi kemi bere angazhime/mbeshtetje per implementimin e projekteve prioritare dhe pergatitjen e pjeses teknike per projektet e parapara per realizim.

Ne kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës përballë obligimeve në fushën e transportit kemi përgatitur raportin për KE-në për Kosovën për vitin 2018.

Poashtu kam përcjelle nga afër përgatitjen e raportit për kuartalin K4 për vitin 2017 të PKZMSA-së rreth realizimit të objektivave/aktivitetëve në kuadër të planit të Qeverisë për realizimin e obligimeve të MSA-së.

Në grupin punues gjatë takimeve kemi diskutuar mbi hartimin e planit për menaxhim të rrezikut në Ministrinë e Infrastrukturës edhe për dy vitet pasardhëse. Poashtu është themeluar grupi punues për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MI, pjesë e të cilit jam.

Në kuadër të bashkëpunimit në mes ministrisë dhe komunave respektivisht bashkëpunimit të aktivitetëve rreth projekteve infrastrukturore kemi vizituar një pjesë të madhe të komunave për koordinim, përkrahje financiare në projektet e nisura dhe vazhdimin me projekte të reja. Të gjitha vizitat që kam realizuar kanë qenë në kuadër të vizitave të Kabinetit të Ministrit dhe Ministrisë.

Kam përcjelle aktivitetet e planifikimit të buxhetit për projektet e infrastrukturës rrugore dhe monitorimin e realizimit të projekteve në infrastrukturën rrugore.

Nga objektivat e punës në infrastrukturën rrugore në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës kam përcjellur:

- Implementimi i projektit të Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit.
- Bashkëpunimi me Institucionet Financiare Ndërkombëtare.
- Projekti i zgjerimit të rrugës Regjionale R102 Komoran – Skenderaj.
- Programi i rehabilitimit të rrugëve Nacionale dhe Regjionale.
- Programi i bashkëfinancimit me Komuna për përmirësimin e gjendjes së rrugëve lokale.

Si dhe kam marrë pjesë në takime të komisioneve nderministrorë dhe kam përfaqësuar ministrinë në takime me institucione financiare si BERZH, dhe në Këshillin Kombëtar për Investime Kapitale.

Projektet e Autostradave :

Autostrada R6, Prishtinë – Hani i Elezit;

Drejtimi Rrugor 6 në kuadër të rrjetit të Transportit të Evropës Juglindore e cila lidhë Korridoret VIII dhe X në Maqedoni me Prishtinën, ka një rëndësi të veçantë ekonomike për Kosovën dhe rajonin, duke i integruar kryeqytetet e rajonit dhe qendrat ekonomike në rrjetin rajonal të transportit.

Pas përfundimit të nënsegmentit C2 nga Kyqja Babush – Kyqja Ferizaj, me gjatësi të përgjithëshme prej 11 km, është duke vazhduar me punime në trasenë drejtimi Kyqja Doganaj – Hani i Elezit.

Ne kuadër të këtij projekti kam koordinuar aktivitete me përfaqësuesit e Kuvendeve Komunale Ferizaj, Kaçanik dhe Hani i Elezit si dhe përfaqësuesit e Komunitetit, lidhur me kërkesat për rruge lidhëse, nënkalime dhe mbikalime në segmentet C2 Kyqja Babush – Kyqja Ferizaj – Kyqja Doganaj dhe segmentin C3 Kyqja Doganaj – Hani i Elezit.

Kam realizuar disa takime me Komunen e Hanit të Elezit lidhur me procesin e dislokimit të varrezave në Hanin e Elezit, pune të cilën e kemi mbaruar me sukses.

Përgatitjet për Instalimin e Sistemit të ITS (Intelligent System of Transport).

Si pjesë e projektit Zbatues të Autostradës R6 dhe R7, janë të identifikuara Lokacionet për Shenjat VMS (Variable Message Signs), Lokacionet e Shesheve për Pagesa dhe Lokacionet për ndërtimin e qendrës së Kontrollit të trafikut.

Në kuadër të Implementimit të Projektit të Autostradës R6 do të punohet Projekti Zbatues për ITS si dhe Specifikacioni teknik i paisjeve.

Ne kuadër të Marreveshjes së bashkëpunimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë, me datë 04 Prill, 2017, është nënshkruar Protokoli i bashkëpunimit i cili përfshinë perkrahjen e Shtetit Hungarez për disa sektorë të rëndësishëm në Republikën e Kosovës.

Si pjesë e kësaj Marreveshje është përfshirja e Projektit për Sigurinë Rrugore me Menaxhimin e Trafikut në Rrugët Nacionale N2 Prishtinë - Mitrovicë - Leposaviq - Kufiri me Serbinë edhe N9 Prishtinë - Pejë, si dhe Instalimin e Sistemit ITS (Intelligent Transport System) në sektorin e transportit.

Janë duke u definuar Termat e Referencës për hartimin e projektit të ITS si dhe komponenteve tjera përcjellëse me qëllim të fillimit të implementimit të projektit.

Ne kuadër të këtij projekti kam përfaqësuar Ministrinë e Infrastrukturas bashkë me ekspert të fushës nga Ministria, në takimin e organizuar nga ana e Toll Services në Budapest, me datë 12-14 Mars 2018. Në këtë takim është arritur harmonizimi Draft Dokumentit për Sistemin e Rritjes së sigurisë rrugore përmes vendosjes së Sistemit ITS, në rrugët Nacionale N2 dhe N9.

Kemi marre përvojat për Sistemet e menaxhimit të trafikut, situatat e përditshme dhe projektimin e vendndaljeve për Autobusë në Rrugët shtetërore dhe sistemi i menaxhimit të orareve të qarkullimit.

Pas kesaj periudhe,tani aktualisht jemi ne prag te vazhdimit te shume projekteve me rendesi nacionale dhe fillimit te projekteve te reja me rendesi lokale,regjionale dhe nacionale. Per cka jam i angazhuar me kapacitet te plote ne menaxhimin,mbikqyrjen e realizimit te suksesshem te ketyrë projekteve ne kuader te programit vjetor te Ministrise dhe te Qeverise se Republikes se kosoves.

Angazhimet tjera jane sipas agjendave ditore te planifikimit te Ministrise se Infrastruktures.

Me respekt,
Fehmi Mujota
Zv.Minister –Ministria e Infrastruktures